

## **Thirrje e hapur për projekt-propozime 2023-2025**

Në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës, nënshkruar më 8.03.2010, hyrë në fuqi më datë 1.12.2011, miratuar me VKM Nr. 265 datë 21.04.2010, “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës”, Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe Inovacionin (AKKSHI), çel raundin e dytë të thirrjeve për aplikime të përbashkëta kërkimore, tekniko- shkencore, mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Kjo thirrje do të jetë është hapur prej datës **24.04.2023 deri më 25.06.2023**, në të cilën kërkues nga të gjitha fushat e kërkimit dhe në të gjitha fazat e karrierës, të asociuar me një institucion kërkimor janë të ftuar të paraqesin projekt-propozimet e përbashkëta.

Koordinatorët e grupeve të kërkimit të secilit vend janë të lutur të dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, pranë institucioneve respektive. Për kërkuesit nga Shqipëria, institucion përgjegjës do të jetë Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit. Për kërkuesit nga Kosova institucion përgjegjës do të jetë Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit Kosovë.

Të gjithë të interesuarit, janë të lutur të aplikojnë duke mbushur kërkesat dhe formularët e aplikimit, në dokumentacionin bashkëlidhur kësaj thirrje:

- **3 kopje të projekt-propozimit në gjuhën shqipe ;**
- **3 kopje të CV-ve të gjithë pjesëtarëve të grupeve të kërkimit të të dyja vendeve ;**
- **1 shkresë përcjellëse nga titullari i institucionit ;**
- **1 kopje CD ku të ngarkohet i gjithë dokumentacioni i kërkuar ;**

Dokumentat do të dorëzohen në versionet *hard- copy dhe soft copy(CD)*, pranë Agjencisë Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe Inovacion (AKKSHI), me adresë Rruga Naim Frashëri, Nr.37, Tiranë, **brenda afatit të parashikuar për këtë thirrje.**

Projekt-propozimet do të shqyrtohen dhe me tej vlerësohen, **sipas sistemeve të miratuara të vlerësimit në secilin shtet**, ndërsa fituesi do të shpallet **pas krahasimit të vlerësimeve në të dy shtetet.**

Projekt-propozimet fituese, do të financohen për një afat kohor prej **2-vitesh dhe shuma e grantit për secilin vit, nuk do të jetë më lartë se 5000 EUR**, të cilat do të konvertohen në ALL me kursin e këmbimit të datës në të cilën do të bëhet aplikimi.

## **Kujdes:**

- Jeni të lutur të detajoni shumë e kërkuar për financim sipas tabelës së paraqitur në projekt propozim, në ALL dhe në EUR. Gjithashtu vëmë në dukje se fondet që do të alokohen për qëllim të këtij projekti **do të përdoren vetëm për qëllimin e realizimit të mobiliteteve të kërkuesve**. Nevojat për pajisje mund të mbulohen nga institucionet e kërkimit me të cilin janë të asociuar kërkuesit.
- Lutemi të paraqisni në mënyrë sa më të detajuar **Objektivat** dhe **Aktivitetet** që do të realizoni në projekt-propozim për secilin vit.
- Lutemi që të interesuarit për të marrë pjesë në projekte dypalëshe kërkimi-shkencor dhe në programet kombëtare përkatëse, për thirrjet në vazhdim t'u referohen faqes sonë zyrtare në internet: [www.nasri.gov.al](http://www.nasri.gov.al) , pasi kjo do të jetë mënyra e vetme e komunikimit të thirrjeve në vijim. Në të do të pasqyrohen të gjitha thirrjet e hapura për projekte kërkimi shkencor dhe detajet e aplikimit.

Duke Ju falënderuar për interesimin,